

KOLEC TOPALLI (1938-2018)

Në datën 24 maj të vitit 2018 u nda nga jeta pas një sëmundjeje të rëndë profesor Kolec Topalli, anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, “Mësues i Popullit”, studiues i shquar i gjuhës shqipe dhe i historisë së saj.

Profesor Kolec Topalli lindi në Shkodër në vitin 1938, në një familje të njohur shkodrane. Për shkaqe biografike të familjes provoi përndjekje nga regjimi komunist që në moshë të njomë duke u dëbuar në kampe internimi me kushte shumë të vështira jetese.

Shkollën e mesme e kreu në Shkodër, ku mbaroi edhe Institutin e Lartë Pedagogjik Dyvjeçar të këtij qyteti. Mbaroi shkëlqyeshëm studimet e larta për gjuhë e letërsi shqipe në Universitetin e Tiranës (1964), punoi si mësues në fshatra të ndryshme të Shqipërisë, si Kukës, Lezhë, Gramsh e Krujë, ku fitoi përvojë edhe nga njohja në terren e gjuhës shqipe. Duke qenë mësues në Nikël të Krujës, ai ra në kontakt me drejtues të arsimit, të cilët i kërkuan mendim lidhur me disa tekste, mendim i cili u vlerësua shumë nga profesori i gjuhës shqipe Fatmir Agalliu i cili e nxiti ta botojë studimin e tij. Kështu nisi rruga e vështirë dhe e pasionuar drejt studimit të gjuhës shqipe nga Kolec Topalli. Gjatë viteve të shërbimit në arsim ai përgatiti dy disertacione (1986, 1991).

Mbas kthesës politike të vitit 1990 Kolec Topalli, i përfshirë nga lëvizja demokratike e kohës dhe i vlerësuar nga drejtuesit e pushtetit të ri pluralist, u emërua Sekretar i përgjithshëm i Presidentit të Republikës (1992–1997). Por dëshira e tij e hershme ishte puna shkencore me kohë të plotë në fushën e gjuhësisë, të cilën nuk e ndërpreu asnjëherë edhe në detyrat politike. Në vitin 1997 ai kaloi punonjës shkencor në Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë, ku, me përjashtim të një viti pune si këshilltar në ambasadën e Shqipërisë në Romë (2006), nuk i shkëputi asnjëherë marrëdhëniet e punës, edhe mbas daljes në pension në vitin 2007, kur punoi si koordinator shkencor në Qendrën e Studimeve Albanologjike (2007-2014).

Veprimtarinë shkencore në fushën e studimeve diakronike të shqipes prof. Kolec Topalli e nisi që në vitet '70 dhe e vazhdoi atë me hapa të vazhdueshëm e sistematikë deri në realizimin e një numri të rëndësishëm monografish në fushën e fonetikës historike e më pas në atë të morfologjisë historike, të cilat sollën botimin e dy veprave madhore “Fonetika historike e shqipes” dhe “Gramatika historike e shqipes”. Gjatë gjithë kësaj pune atë e

udhëhoqi pasioni për shkencën e gjuhësisë dhe dashuria për gjuhën shqipe, shoqëruar me vullnetin e punën e palodhur kërkimore në një fushë ku ishin përballur me vështirësitë e shumta që paraqet historia e gjuhës shqipe breza të tërë albanologësh joshqiptarë e shqiptarë prej më se një shekulli e gjysmë. Studimet për rindërtimin e historisë së gjuhës shqipe, të fonetikës dhe gramatikës së saj, e çuan natyrshëm autorin edhe te rindërtimi i historisë së fjalëve, të origjinës së tyre, të zbulimit të kuptimeve më të hershme apo të kryehershme të tyre, pra te etimologjia e fjalëve të shqipes dhe pasqyrimi i tyre në një fjalor etimologjik, vepra e tij e fundit madhore. Pak para se të ndërronte jetë, Koleci kishte ndër gëzimin e botimit të fjalorit të tij etimologjik, të cilit i kishte kushtuar gjashtë vitet e fundit të jetës së tij.

Prof. Koleci ishte dhe një edukator i mirë i studentëve në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë. Ai ka dhënë leksione të Fonetikës historike për 15 vjet rresht, gjatë të cilave kanë dalë disa breza të diplomuarish në gjuhësi, të cilët kanë pasur fatin të marrin leksione prej tij. Akademik Kolec Topalli është autor i shumë veprave të rëndësishme studimore mbi gjuhën shqipe, monografi, përmbledhje studimesh dhe vepra kolektive si “Theksi në gjuhën shqipe” (1995); “Për historinë e hundorësisë së zanoreve në gjuhën shqipe” (1996); “Zhvillimi historik i diftongjeve të shqipes”(1998); “Shndërrime historike në sistemin zanor të gjuhës shqipe” (2000); “Fonetika historike e gjuhës shqipe” (2007); “Sonantet e gjuhës shqipe” (2001); “Mbylltoret e gjuhës shqipe” (2002); “Fërkimoret e afrikatet e gjuhës shqipe” (2003); “Dukuritë fonetike të sistemin bashkëtingëllor të gjuhës shqipe” (2004); “Bazat e fonetikës historike të gjuhës shqipe” (2005); “Ricerche sulla storia dell’accento in Albanese” (2007); “Evolucioni historik i përemrave të shqipes” (2008); “Sistemi rasor i emrave të shqipes” (2009); “Nyjat e shqipes” (2009); “Sistemi foljor i gjuhës shqipe” (2010); “Gramatikë historike e gjuhës shqipe” (2011); “Bazat e gramatikës historike të gjuhës shqipe” (2011) si dhe botimi i tij më i fundit “Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe” botuar në vitin 2017. Veprat e tij arrijnë në mbi 250 tituj me rreth 10.000 faqe: monografi, artikuj e kumtesa, me botime në 5 gjuhë të huaja, duke lënë pas kështu një trashëgimi të vyer në kulturën shqiptare. Ai ka qenë bashkëpunëtor i 30 revistave shkencore brenda e jashtë vendit, ka marrë pjesë me kumtesa në 120 konferenca shkencore kombëtare e 58 ndërkombëtare dhe ka ligjëruar për historinë e gjuhës shqipe në universitete e qendra shkencore brenda e jashtë vendit.

Ai gjithashtu ka qenë edhe redaktor dhe recensues i një sërë veprash të rëndësishme studimore si “Fjalor fjalësh të rralla të gjuhës shqipe” i Benedikt Demës; “Vepra të zgjedhura” të Selman Rizës; “Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit: aktet e konferencës shkencore, Durrës, 15-17 dhjetor 2010”; “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe” i Anila Omarit; “Fonetikë akustike: analizë e sistemit fonologjik” i Aljula Jubanit; “Komisia letrare shqipe në Shkodër (1916-1918) dhe Shoqëria e

të Shtypurit Shkronja Shqip (1879), Shoqëria “Bashkimi” (1899), Shoqëria “Agimi” (1901)” dhe “Shekulli i Komissisë Letrare Shqipe në Shkodër: (1916-1918): 100 vjet të rrugëtimit të saj” të autorit Tomor Osmani; etj.

Në vitin 2008 është zgjedhur anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe më 2012 anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Disa nga veprat e tij më të mira janë nderuar me çmime prestigjioze. “Gramatikë historike e gjuhës shqipe” u nderua me çmimin e revistës “Kult” 2012, si vepra shkencore më e mirë e vitit, Fjalori Etimologjik i Gjuhës shqipe ishte fitues i Çmimit “Çabej”, Edicioni II, si vepra më e mirë shkencore e vitit 2017 në fushën albanologjike.

Senati Akademik i Qendrës së Studimeve Albanologjike i ka dhënë titullin “Profesor Nderi i Studimeve Shqiptare”. Presidenti i Republikës e ka nderuar me urdhrin “Mjeshtër i Madh”.

Me vdekjen e tij Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë dhe Akademia e Studimeve Albanologjike humbën një bashkëpunëtor të pazëvendësueshëm dhe një koleg e mik të nderuar; Akademia e Shkencave humbi një shkencëtar me veprimtari të gjatë dhe cilësore; bota shkencore albanologjike një dijetar të vyer e me përvojë; familja dhe të afërmit njeriun e dashur.

ANILA OMARI